



Bëje vaksinën !

Si vepron një vaksinë?

- Nga vaksina trupi yt krijon antitropa.
- Këto substanca/antitropa ndihmojnë për të luftuar kundër viruseve.
- Nëse më vonë ti bie në kontakt me virusin, atëherë antitrupat të mbrojnë.

Përse është mirë të bëhet vaksinimi?

- Koronavirusi është i rrezikshëm për shumë njerëz afër teje:
 - 65 vjeç dhe më të moshuar
 - njerëzit me sëmundje të mushkërive, të zemrës apo të enëve të gjakut
 - njerëzit me diabet/sëmundje të sheqerit apo me tension/shtypje të lartë të gjakut

Por edhe për njerëzit e ri në moshë dhe të shëndetshëm, ka mundësi që virusi të jetë i rrezikshëm.

- Nëse më tepër se 70% të të gjithë njerëzve në Belgjikë e bën vaksinën, atëherë virusi shpërndahet me më pak shpejtësi. Ky quhet imuniteti i tufës/masës.
- Jeta jote kthehet më shpejt në normalitet.
- E bën trupin tënd më të fuqishëm kundër virusit.
- Por, vazhdo të rrespektosh rregullat deri sa të jenë vaksinuar mjaftueshëm njerëz. Mbaj 1,5 metra distancë, mbaj/vër një maskë për gojë dhe laji shpesh duart e tua.

Si më bëhet vaksina?

- Ty të bëhen dy injeksione/gjilpëra në pjesën e sipërme të krahut.
- Injeksioni/gjilpëra e dytë të bëhet 3 ose 4 javë pas injeksionit të/gjilpërës së parë.
- Pas injeksionit të/gjilpërës së dytë duhet të presësh 14 ditë. Pastaj vaksina të jep mbrojtjen më të mirë të mundshme kundër koronavirusit.



A është e sigurtë vakcina?

- Në prodhimin e vaksinës përdoret shumë ekspertizë. Shkencëtarë dhe ekspertë farmaceutike nga e gjithë bota kanë mundur të zbulojnë vaksinën në kohë të shkurtër. Pati gjithashtu shpejt mjaftueshëm para dhe kohë për t'a bërë këtë sepse kjo gjë ishte shumë urgjente.
- Së pari, vakcina është kontrolluar rreptësisht nga qeveria. Ajo është e sigurtë.

A mund të kem ankesa pas vaksinimit?

Ndoshta ty të shkaktohet

- pak skuqje, dhimbje apo enjtje në pjesën e sipërme të krahut tënd
- lodhje
- dhimbje koke
- pak temperaturë më e lartë

Kjo është normale dhe jo një gjë serioze. Për këtë ti mund të marrësh një paracetamol.

Kur më bëhet vakcina?

- Në janar:
 - banorët dhe personeli i qendrave/shtëpive të kujdesit (azileve të pleqve)
 - personeli i kujdesit shëndetësor (mjekët, infermierët, ...) e spitaleve.
- Në shkurt:
 - personeli i kujdesit shëndetësor të linjës së parë (mjekët e familjes, farmacistët, ...)
 - shërbimet e kujdesit kolektiv (kujdesi për personat me aftësi të kufizuara, ...) dhe personeli tjetër i spitaleve
- Mars:
 - 65 vjeç dhe më të moshuar
 - njerëzit me rrezik të shtuar nga shëndeti i tyre
- Prill:
 - njerëzit me një profesion esencial/thelbësor
- Nga qershori:
 - gjithësecili më i moshuar se 18 vjeç

Ky afat kohor mund të ndryshojë.



Disa njerëz nuk lejohen të bëjnë vaksinë. Për shembull: pacientët me kancer, shtatëzënat/gratë me barrë ose njerëzit me alergji ekstreme. Kontakto mjekun/doktorin tënd për informacione të mëtejshëm.

Si e di unë se kur më bëhet vakcina?

- Ty të vjen një ftesë me letër, sms dhe/ose e-mail.
- Ti regjistrohesh me anë të internetit ose duke telefonuar.
- Nëse momenti nuk është i përshtatshëm, atëherë ti mund të zgjedhësh një moment tjetër.
- Nëse nuk reagon, atëherë bashkia apo komuna të kontaktojnë.

Ku mund t'a bëj vaksinën?

Në një qendër vaksinimi (vaccinatiecentrum).

Sa kushton një vaksinë?

Ajo është falas.

Do informacione të mëtejshëm?

<https://www.laatjevaccineren.be/>

www.info-coronavirus.be/nl/vaccinatie